



Njoftim vendimi

Postuar në : 30/01/2024



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, i përbërë nga Ina Rama kryesuese, Rezarta Schuetz raportuese, Albana Shtylla, Mimoza Tasi, Sokol Çomo anëtare, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 18/2021, datë 14.04.2021, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Mariana Shegani (Dedi) kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 350, datë 23.02.2021.

Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash, vendosi:

– Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 350, datë 23.02.2021 dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi).

– Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.01.2024.